

FJALA E DEPUTETES BLERINA GJYLAMETI

E HËNË 8 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Në këto ditë të diskutimeve për buxhetin në Komisionin e Ekonomisë, kemi parë dy anë të medaljes. Në një anë shikojmë vetëm zi, zi, zi, zi, korrupsion, vjedhje, kemi parë se mungojnë shërbimet, kemi dëgjuar sa janë shifrat, pse nuk na i jepni shifrat, ndërkohë shifrat janë çdo ditë dhe së bashku me ministrat, i kemi dëgjuar, kemi diskutuar mbi realizimin e buxhetit, mbi projektbuxhetin e vitit 2022, kemi diskutuar se cilat janë shtyllat kryesore të këtij projektbuxheti dhe përse do të duhej që të ndryshonim me akte normative për të disatën herë, pikërisht me synimin kryesor jo thjesht dhe vetëm rimëkëmbjen ekonomike, që është synimi i parë, por për mbështetjen e të gjitha shtresave në nevojë, po ashtu edhe financimin e të gjithë atyre që u prekën nga tërmeti i vitit 2019 dhe për të vijuar më tutje me atë çfarë është jo vetëm ruajtja e treguesve makrofinanciarë, por, gjithashtu, nëpërmjet rimëkëmbjes së ekonomisë, ruajtjen e vendeve të punës dhe më tej akoma sigurimin e të ardhurave që nevojiten në buxhet për ato që janë investimet kryesore në infrastrukturë. Kuptohet, teksa dëgjon gjatë gjithë kohës zi, në anën tjetër shikojmë njerëz që kanë një përgjegjësi maksimale për fjalët që thonë, sepse ato do të duhet të shoqërohen edhe me vepra.

Ndërkohë, në anën tjetër fjala është e vetmja gjë që kanë në dispozicion. Kështu që edhe pjesa e akuzës është shumë e thjeshtë. Akuzo, akuzo dhe, kur marrin argumente, kalojnë në fazën tjetër dhe thonë: “Nuk janë të vërteta”. Besoj që si maxhorancë jemi më se të vetëdijshëm që borxhi i lartë në terma afatgjatë mund të cenojë atë që është zhvillim i qëndrueshëm, por nëse ka një moment, që na jep siguri në vendimin e duhur, është fakti se e kemi treguar ndër vite që me një përgjegjshmëri të plotë, përveç dy vjetëve të fatkeqësisë, borxhi publik ka qenë në trajektore rënëse. Rishikimi i këtij buxheti në vitin 2021 vjen pikërisht pas rivlerësimit të ecurisë së treguesve makrofinanciarë, si dhe të nevojës që lidhet me përballjen me krizën energjetike, por, nga ana tjetër, edhe me kushtet e favorshme që janë në tregjet financiare ndërkombëtare. Kuptohet që kjo është një mbështetje në mënyrë të veçantë për sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm me energji dhe për të ofruar atë që i nevojitet OSHEE-së për ta bërë të mundur këtë. Nuk mund të bëjmë sot sikur nuk e shohim çfarë ndodh në tregjet ndërkombëtare dhe nuk mund të bëjmë sikur nuk e kuptojmë se me çfarë po përballet edhe Europa. Ndaj, është detyrë e kësaj maxhorance që të marrë në kohën e duhur vendimet e sakta, në dobi të ekonomisë së vendit dhe të qytetarëve të saj. Pati edhe nga ata, që gjatë periudhës së pandemisë, anatëmuar çdo vendimarrje, qoftë pjesën e vaksinimit, qoftë të kufizimeve, po ashtu edhe të mbylljes së bizneseve me sigurimin e jetës së qytetarëve në radhë të parë dhe, po ashtu, vazhduan edhe me pjesën tjetër, edhe për mbështetjen: kishte mbështetje, nuk kishte mbështetje; ishte pak, do të duhej të ishte shumë, ndërkohë që, në anën tjetër, koha jo vetëm na dha të drejtë, por provoi se, nga njëra anë, ishte zgjedhja e duhur për të ruajtur shëndetin e qytetarëve, në radhë të parë dhe, nga ana tjetër, pikërisht për t'i dhënë frymëmarrje ekonomisë në kushte shumë të vështira.

Ky akt normativ është më se i domosdoshëm sot, sepse jo vetëm krijon të gjitha mundësitë për mbështetjen e OSHEE-së për të përballuar rritjen e menjëhershme të çmimeve, por, së dyti, pasqyron edhe në ligjin e buxhetit të gjitha nevojat reale që kemi për financimin nëpërmjet eurobondit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Aktualisht, këto tregje kanë likuiditet të lartë dhe norma interesit të ulëta, gjë e cila do të thotë se do të duhet të përfitojmë, madje për t'i shfrytëzuar këto kushte do të duhet të dalim sa më shpejt në tregjet ndërkombëtare. Paralajmërimet e bankave qendrore flasin

për një rritje të kostove dhe të interesave, është e vërtetë, ndaj edhe zgjedhja për të emetuar eurobond në këtë vit është në favor të interesave ekonomike të vendit me norma dhe interesa me kosto shumë më të ulët. Mjafton të shikojmë trajektoren e normave të interesit sa herë kemi dalë në tregjet ndërkombëtare për eurobondin, për të kuptuar se jo vetëm ka pasur një mbështetje dhe besim në ekonominë shqiptare, por kjo u ka kushtuar më pak qytetarëve shqiptarë. Duke konsideruar projeksionet më të fundit mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe identifikimin e nevojave të reja për financim, eurobondi rezulton alternativa më e përshtatshme, duke shmangur edhe nevojat që mund të kemi gjatë vitit 2022. Theksoj që nëpërmjet këtij akti normativ nuk ka ndryshime në treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2021.

Pra, në thelb deficitin nuk preket, por ndryshojnë dhe rialokohen zërat brenda kufijve të borxhit publik dhe financimit të buxhetit të vitit 2021. Financimi i siguruar nga eurobondi do të përdoret në mbështetje të përgjithshme buxhetore dhe do të aplikohet për shpenzime publike për sektorët kryesorë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura dhe në mbështetje të investimeve publike. Të nderuar kolegë, Tërmeti i vitit 2019 dhe, po ashtu, pandemia Covid-19, ndikuan në ecurinë ekonomike të vendit tonë dhe rritën edhe ekspozimin ndaj vendeve fqinje dhe rreziqeve fiskale. Sigurisht, qeveria ndërmoi një sërë nismash dhe masash për punësimin, për rimëkëmbjen ekonomike, duke përfshirë mbështetjen për bizneset e vogla në mënyrë të veçantë, të mesme dhe të mëdha. Fondet për masat në ndihmë të punësimit u rritën me 12,7 miliardë lekë dhe shkuan për 243500 biznese dhe individë të prekur nga pandemia nëpërmjet pagave të luftës. Ndërkohë, 23320 përfitues përfituan nga mbështetja financiare në zbatimin e masave protokollare anti-Covid me një kosto prej 118 milionë lekësh. Gjithashtu, u aktivizuan dy garanci sovraane për mbështetje ndaj biznesit dhe të ndërmarrjeve të mëdha. Që nga rihapja e ekonomisë dhe masave për mbështetje financiare për sipërmarrjen dhe për individin është provuar se ka dhënë rezultat dhe ka qenë vendimi i duhur, sepse ka treguar se si ka ndikuar pozitivisht në punësim, në ekonomi dhe në më shumë të ardhura. Emetimi i eurobondit nuk është surprizë. Fakti që kemi emetuar disa eurobonde, siç e përmenda edhe më parë, të suksesshme dhe që normat e interesit kanë ardhur gjithmonë në ulje; maturitetet kanë ardhur në rritje, do të thotë që qeveria shqiptare jo vetëm është gjithnjë e më shumë e besueshme në tregjet ndërkombëtare, por, gjithashtu, edhe të investohet në bondet e kësaj qeverie. Paratë do të përdoren për të financuar pjesërisht buxhetin dhe, po ashtu, në ato që përmenda pak më parë, në sektorët kyç, si: shëndetësia, infrastruktura, për t'u përdorur edhe për vitin e ardhshëm. Krahas investimeve, sigurisht, ne do të mbështesim edhe rritjen e pagave gjatë vitit të ardhshëm, ku parashikohet që do të ketë një 6% rritje të pagës për sektorët kryesorë, si: shëndetësia, infermierët, për administratën publike dhe, gjithashtu, edhe të rritjes së pagës minimale. Për sa më sipër rendita, mendoj se janë të gjitha argumentet e nevojshme për ta miratuar këtë nismë që do të ndihmojë dhe do të kontribuojë në mbarëvajtjen e ekonomisë sonë. Faleminderit!